



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL
ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

PROJEKT-VENDIM

Nr. Datë . .2026

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE FAMILJEVE QË JANË LARGUAR
NGA SISTEMI I PIKËZIMIT TË CILAT NUK KANË MARRË PIKËT E
MJAFTUESHME PËR MUAJIN PRILL 2026, PËR PËRFITIM NGA FONDI I
KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËN DERI NË 6%.**

Duke u mbështetur në Ligjin nr 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, i ndryshuar, Vendimi nr. 855, datë 26.12.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, udhëzimit nr. 5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%” të Ministrisë së Mirëqenies Sociale, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.4, datë 27.01.2026 “Për miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike nga përdorimi i fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të bllok - ndihmës ekonomike deri në 6% për vitin 2026”, Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve me propozim të Kryetarit të Bashkisë i kërkon Këshillit Bashkiak të miratojë në mbledhjen e datës _____:

PROPOZOI:

- 1-Dhënie e ndihmës ekonomike për 16 familje për muajin prill 2026 sipas listave bashkëngjitur Projekt - Vendimit duke qenë se këto familje plotësojnë të gjitha kriteret sipas vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr.4, datë 27.01.2026.
- 2- Fondi total prej 53'766 lekë do të përballohet nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën deri në 6 % për muajin mars 2026.
- 3-Për zbatimin e këtij projekt-vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria e Shërbimit Social dhe Administrata e Bashkisë Kolonjë.
- 4-Ky projekt-vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli Bashkiak.

Konc: Spec A. Dajlani

**KRYETARI
ERION ISAI**

NË MUNGESË DHE ME URDHËR



Adresa: Sheshi “Rilindja”, 7404, Ersekë, Kolonjë, www.kolonja.gov.al, email: info@kolonja.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL
ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

Nr. 3179 prot.

Datë 22.05.2026

RELACION
PËR
PROJEKT-VENDIM
Nr. Datë ____ / ____ /2026

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE FAMILJEVE QË JANË LARGUAR
NGA SISTEMI I PIKËZIMIT TË CILAT NUK KANË MARRË PIKËT E
MJAFTUESHME PËR MUAJIN PRILL 2026, PËR PËRFITIM NGA FONDI I
KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËN DERI NË 6%.**

Duke u mbështetur në Ligjin nr 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, i ndryshuar, Vendimi nr. 855, datë 26.12.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, udhëzimit nr. 5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%” të Ministrisë së Mirëqenies Sociale, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.4, datë 27.01.2026 “Për miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike nga përdorimi i fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të bllok - ndihmës ekonomike deri në 6% për vitin 2026”, Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve paraqet për miratim në Këshillin Bashkiak listën e familjeve bashkëngjitur projekt-vendimit.

Në zbatim të procedurës për përfitimin e ndihmës nga fondi 6%, familjet aplikuese në sistemin kombëtar të menaxhimit të ndihmës ekonomike, të cilat janë refuzuar për arsye pikëzimi, rekomandohen nga administratori shoqëror për trajtim me ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6%. Të gjitha familjet i nënshtrohen paraprakisht verifikimit të situatës social-ekonomike. Për muajin prill janë rekomanduar të gjitha familjet që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme në sistem, dhe është refuzuar familja Mimoza Hoxha e cila ka dalë në pension dhe Aurel Qirici, familje përfituese deri në muajin mars, për kryerjen e procedurës së riaplikimit.


Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Konc: Spec A. Dajlani

**KRYETARI
ERION ISAI**

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

**N/KRYETAR
PETRO RISTO**



Hi	Dritan Shupe	NE-2026-002194	Familjet në nevojë	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2178.00
Hi	Afërdita Kalavace	NE-2026-005879	Familjet në nevojë	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3146.00
Hi	Luljeta Liço	NE-2025-026723	Familjet në nevojë	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3146.00
Sh	Aurel Qirici	NE-2025-014956	Familjet në nevojë	Refuzuar	0.00
Hi	Valentina Nuko	NE-2025-026336	Familjet në nevojë	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2178.00
Hi	Ajet Daut	NE-2026-002085	Familjet në nevojë	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5227.00
Hi	Lirika Shaka	NE-2026-009065	Familjet në nevojë	Rekomanduar per trajtim me fondin 5 %	3146.00
Sh	Mimoza Hoxha	NE-2026-007085	Familjet në nevojë	Refuzuar	0.00
Hi	Fatmir Koxha	NE-2026-005012	Familjet në nevojë	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3703.00
Hi	Lorena Vaso	NE-2023-027926	Familjet në nevojë	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5940.00
Hi	Vasilika Janko	NE-2025-018999	Familjet në nevojë	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3146.00
Hi	Tone Mahmut	NE-2025-015229	Familjet në nevojë	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	7920.00
Hi	Edmond Shaka	NE-2026-007167	Familjet në nevojë	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2178.00
Hi	Lefteri Mukaj	NE-2026-003553	Familjet në nevojë	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2178.00
Hi	Ylli Çabej	NE-2025-027357	Familjet në nevojë	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2178.00
Hi	Teuta Çaushti	NE-2025-025911	Familjet në nevojë	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3146.00

Hi	Ilir Veis	NE-2026-006086	Familjet në nevojë	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2178.00
Hi	Enkeleda Meka	NE-2026-009246	Familjet në nevojë	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2178.00